



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 25, datë 14.12.2022

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "GREEN COAST II, ZONA A2
"OBJEKT HOTELERI DHE SHËRBIME 1 DHE 3 KATE,
ME 2 KAT NËNTOKË DHE PISHINË",
ME VENDNDODHJE NË PALASË, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja "ç", 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Aqua Marine" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Green Coast II, Zona A2 "Objekt hoteleri dhe shërbime 1 dhe 3 kate, me 2 kat nëntokë dhe pishinë", me vendndodhje në Palasë, Bashkia Himarë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Aqua Marine" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

